



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 3 mars 2022  
Nr. Ref.: RK 1951/22

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI189/21**

Parashtrues

**Zeqirja Murina**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës  
Supreme të Kosovës, AC-I-20-0550-A0001, i 7 tetorit 2021**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Zeqirja Murina, me vendbanim në Kamenicë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), AC-I-20-0550-A0001, të 7 tetorit 2021 në ndërlidhje me Aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), C-IV-13-0569 i 9 nëntorit 2020.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 25 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 4 nëntor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Gjykata poashtu njoftoi edhe DHPGJS-në për regjistrimin e kërkesës, në po të njëjtën ditë.
7. Më 08 nëntor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 16 shkurt 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Parashtruesi i kërkesës ishte punëtor në Ndërmarrjen Shoqërore “Xim Strezovci” deri në dhjetor 2007.
10. Më 31 dhjetor 2010, N.SH “Xim Strezovci” ka hyrë në procedurën e likuidimit.

11. Më 21 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Agjencionin Kosovar të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) përmes së cilës kërkoi që t'i kompensohen pagat e papaguara për periudhën dhjetor 2006 deri dhjetor 2007 në vlerë prej 3,484.07 Euro.
12. Më 4 prill 2013, Autoriteti i likuidimit pranë AKP-së, përmes Vendimit GJIo66-0036, pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, dhe kompensoi atë në shumën prej 1,740 Euro, duke u bazuar në arsyetimin për kompensim të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, për arsye se marrëdhënia e punës së parashtruesit është ndërprerë me 13 dhjetor 2007 për shkak të privatizimit të N.SH "Xim Strezovci". Autoriteti i Likuidimit u referua në paragrafin 1.6.2 të nenit 40 të Shtojcës së Ligjit r. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Ligji për AKP-në). Në arsyetimin e tij Autoriteti i Likuidimit theksoi se në llogaritjen e shumës, ka marrë parasysh pagën mujore në momentin e pushimit nga puna dhe vitet faktike të shërbimit në punë. Vitet e punës së parashtruesit janë llogaritur duke numëruar periudhën e punësimit në N.SH, nga data e rekrutimit në punë e deri në muajin e fundit të shërbimit. Në këtë aspekt, bazuar në paragrafin 7 të nenit 76 të Ligjit të Punës, kompensimi i takoi parashtruesit të kërkesës për gjashtë (6) rroga mujore.
13. Më 17 prill 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në DHPGJS, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të N.SH "Xim Strezovci". Parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me përfundimin e Autoritetit të Likuidimit lidhur me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, sepse konsideron se Autoriteti i Likuidimit tenton t'i ikë përmbushjes së obligimeve të tij, ashtu siç janë të përcaktuara me nenin 40 të Ligjit për AKP-në. Parashtruesi i kërkesës konsideron se në rastin konkret, ai ka dorëzuar ankesën brenda afatit andaj konsideron se *"nuk bëhet fjalë për vjetërsim të paraqitjes së kërkesave"*.
14. Më 11 dhjetor 2014, AKP dorëzoi mbrojtje ndaj ankesës së dorëzuar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit. AKP konsideron se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, dhe konsideron se marrë parasysh që kërkesa konsiston për periudhën kohore prej dhjetorit 2006 e deri në dhjetor 2007, afati i parashkrimit i kësaj kërkesë ka arritur në dhjetor 2009, përderisa e njëjta është parashtruar tek Autoriteti i Likuidimit më 21 shkurt 2010.
15. Më 9 nëntor 2020, shkalla e parë e DHPGJS-ës, përmes Aktgjykimit C-IV-13-0569 refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, dhe vërtetoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Shkalla e parë e DHPGJS-së, refuzoi si të pabazuar ankesën, duke u bazuar në paragrafin 2 të nenit 42 të Ligjit mbi DHGJS-në, i cili parasheh që kur pala pretendon një fakt apo ngjarje, ai ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa paragrafi 3 i nenit 42 i këtij ligji, parasheh që pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar prova materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon ta paraqesë apo të dorëzojë prova të tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë. Me këtë rast, shkalla e parë e DHPGJS-së iu referua edhe nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Rrjedhimisht, shkalla e parë, theksoi se parashtruesi i kërkesës, nuk ka ofruar dëshmi relevante që dëshmon se N.SH i ka

mbetur atij borxh pagat e kërkuara, përkatësisht faktin që ai ka ofruar shërbime për N.SH-në, për periudhën dhjetor 2006- dhjetor 2007.

16. Më 2 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Kolegjit të Apelit, duke pretenduar konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, parashtruesi i kërkesës theksoi se ai si provë ka paraqitur kërkesën që ka parashtruar pranë AKP-së dhe për të cilën ka kërkuar t'i kompensohen pagat e papaguara në shumën prej 3,484.07 Euro, kërkesë kjo e paraqitur pasi N.SH "Xim Strezovci", ka hyrë në procedurë të likuidimit, dhe me këtë ai ka ndikuar që të mos rrjedhë afati i parashkrimit. Parashtruesi i kërkesës, poashtu iu referua edhe nenit 40 të Ligjit për AKP-në i cili përcakton përmbushjen e kërkesave të kreditorëve, sipas prioriteteve. Së dyti, sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, parashtruesi i kërkesës konsideroi se ka paraqitur prova të mjaftueshme përmes të cilave ka vërtetuar pretendimet e tij. Parashtruesi i kërkesës iu referua Aktgjykimit AC-I-14-0119-A0001 duke theksuar se Kolegji i Apelit, ka obliguar AKP-në që personit N.Z, t'ia paguajë shumën përkatëse në emër të pagave të papaguara, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj. Rrjedhimisht parashtruesi i kërkesës konsideroi se është krijuar precedent me këtë rast.
17. Më 7 tetor 2021, Kolegji i Apelit, përmes Aktgjykimit AC-I-20-0550-A0001, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, dhe vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë C-IV-13-0569 të 9 nëntorit 2020. Kolegji i Apelit, theksoi se konsideron se parashtruesi i kërkesës (i) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante për të dëshmuar se N.SH "Xim Strezovci" i ka mbetur atij borxh për pagat e kërkuara; (ii) nuk ka ofruar asnjë dëshmi që vërteton se ai ka ofruar shërbime për NSH-në në periudhën për të cilën kërkon kompensim; dhe (iii) nuk ka ofruar dëshmi për lartësinë e pagës dhe llogaritjen e shumës së kërkuar. Kolegji i Apelit konsideroi se parashtruesi i kërkesës ka ofruar një dëshmi të vetme, përkatësisht Njoftimin e AKP-së për mundësinë e parashtrimit të kërkesave eventuale ndaj NSH-së, por kjo provë nuk është e mjaftueshme për njohjen e së drejtës së pretenduar. Kolegji i Apelit, duke iu referuar përsëri paragrafit 2 të nenit 42 të Ligjit për DHPGJS-në, thekson se shkalla e parë e DHPGJS-së ka vepruar me të drejtë kur ka theksuar se pala që pretendon ndonjë fakt apo ngjarje, e ka barrën e dëshmisë dhe vërtetësisë së pretendimit të tillë, duke parashtruar prova materiale (dokumente fizike dhe dëshmuese), e të cilat parashtruesi i kërkesës ka dështuar të i dorëzojë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit atij i janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së.
19. Parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se atij nuk iu është njohur kompensimi në paga përkundër që ka qenë i punësuar në ndërmarrjen N.SH Xim Strezovci, dhe e njëjta pas likuidimit është e obliguar t'i paguajë ish punonjësve pagat e papaguara.



20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se për raste "identike/njëta" sikurse Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit në rastin e tij, është krijuar një precedent tjetër përmes Aktgjykimit AC-I-15-0178 i 23 prillit 2020. Dhe Aktgjykimit AC-I-14-0119 i 19 dhjetorit 2019. Sipas parashtruesit të kërkesës këto dy (2) Aktgjykime kanë të bëjnë me të njëjtën çështje, bazë faktike e ligjore, palë të paditur, njëjtë si me rastin e parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, për këtë arsye parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese, siç garantohen me nenin 24 dhe 31 të Kushtetutës.
21. Sipas parashtruesit të kërkesës, Kolegji i Apelit, është dashur të vendosë njëjtë për raste identike, dhe me këtë rast parashtruesi i kërkesës i referohet paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit për DHPGJS i cili përcakton se *"Dhoma e Posaçme gjykon në Kolegji të Bashkuar, të përberë nga të gjitha kolegjet e apelit në rastet kur kërkohet përcaktimi i qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin unik të ligjeve apo njësimi i praktikës gjyqësore"*.
22. Për të argumentuar situatën e njëjte faktike dhe juridike parashtruesi i kërkesës thekson se për personat SH.H dhe N.Z, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimeve AC-I-15-0178 dhe AC-I-14-0119, ka obliguar AKP-në që t'iu kompensojë pagat e papaguara personave në fjalë me arsyetimin se *"personat në fjalë kanë qenë të punësuar në N.SH. Xim Strezovci deri në ditën e privatizimit të saj, kur edhe iu janë ndërpre Kontratat e Punës"*.
23. Sipas parashtruesit të kërkesës, personat SH.H dhe N.Z, kanë prezantuar pranë gjykatave të rregullta prova përkatëse, të njëjta me parashtruesin e kërkesës, por në rastin e tij, gjykatat kanë vendosur ndryshe nga praktika. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se vendosja ndryshe në dy çështje identike me mos-marrja parasysh e aktgjykimeve që ai i quan precedent, paraqet devijim i praktikës, interpretim i gabuar i ligjit, dhe gjykim subjektiv i gjykatës, në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.
24. Duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës KI145/18 (*parashtrues Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahim*), Aktgjykim i 19 korrikut 2019), parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin konkret Gjykata ka theksuar se vendosja ndryshe për raste të ngjashme paraqet shkelje të nenit 31 të Kushtetutës. Këtu, parashtruesi i kërkesës i referohet paragrafëve të Aktgjykimit KI145/18, lidhur me mos-arsyetimin e vendimit. Parashtruesi i kërkesës, rrjedhimisht pretendon se pretendimi i tij për precedentin, përkatësisht rastet e njëjta të trajtuara nga Kolegji i Apelit nuk është trajtuar fare nga Aktgjykimi i kontestuar.
25. Parashtruesi i kërkesës, në fund thekson se (i) atij i takon kompensimi për pagat e papaguara; (ii) meqenëse i njëjti ka paraqitur në kohë kërkesën për kompensim të pagave të papaguara, ky fakt ka ndikuar të mos rrjedhë afati i parashkrimit.
26. Parashtruesi i kërkesës, kërkon që Gjykata (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme (ii) të konstatojë shkelje të nenit 24 dhe nenit 31 të Kushtetutës (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I-20-0550-A00001 të 7 tetorit 2021 dhe që çështjen ta kthejë në rivendosje.

## **Dispozitat përkatëse ligjore**

### **LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

#### **Neni 42 Rregullat e përgjithshme mbi provat**

##### **1. Një palë mund të paraqesë prova duke:**

*1.1. paraqitur, ose duke kërkuar nga gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës që të urdhërojë paraqitjen, origjinalin e dokumentit që është i rëndësishëm për një apo më shumë çështje ligjore, ose për pretendimet faktike në lëndën apo procedurat; gjyqtari(ët) mund të pranojë një kopje të dokumentit të tillë në pritje të atij autentik por vetëm nëse pala parashtruese siguron një shpjegim të pranueshëm se përse nuk mund të sigurohet ai autentik;*

*1.2. paraqitur, ose duke kërkuar nga gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës që të ftojë dëshmitarët për të siguruar dëshmi faktike apo çfarëdo dëshmi tjetër gjatë procedurave verbale; megjithatë, nëse pala ka për qëllim paraqitjen e një dëshmitari të tillë, atëherë ajo palë duhet t'i sigurojë gjyqtarit(ve) dhe palëve tjera emrin dhe adresën e secilit dëshmitarët së paku pesë (5) ditë para ditës kur dëshmitari paraqet dëshminë;*

*1.3. paraqitur ekspertë të cilët sigurojnë raporte ekspertësh dhe dëshmi ekspertësh gjatë procedurave verbale; megjithatë, pala që ka për qëllim paraqitjen e një eksperti të tillë duhet t'i sigurojë gjyqtarit(ve) dhe palëve tjera emrin dhe adresën e secilit ekspert si dhe përshkrimin e fushës së tij të ekspertizës, së paku pesë (5) ditë para ditës kur dëshmitari paraqet dëshminë;*

*1.4. paraqitur një mjet fizik që është i rëndësishëm për çështjen faktike të lëndës apo procedurës;*

*1.5. paraqitur traktatet, shkrimet dhe materialet e tjera me shkrim, autorët e të cilave janë persona të cilët kanë ekspertizë apo njohuri të veçantë lidhur me lëndën që është thelbësore për çështjen ligjore apo faktike të lëndës apo procedurës;*

*1.6. kërkuar nga gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës që të urdhërojë shikimin e terrenit apo inspektimin e një objekti; kjo kërkesë shoqërohet nga një shpjegim ku tregohen faktet që duhet konfirmuar nëpërmjet shikimit apo inspektimit të tillë; dhe*

*1.7. paraqitur çfarëdo dëshmi tjetër që lejohet nga gjyqtari(ët) i lëndës apo procedurës, po që se gjyqtari(ët) së pari përcakton se pala ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme se dëshmia e tillë pritët të jetë e rëndësishme për çështjen ligjore apo faktike të lëndës apo procedurës.*

2. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuar). Secilës palë tjetër do t'i jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtresave apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuar) me anë të së cilave synohet përgënjeshtrimi i legjitimitetit apo saktësisë së provave të tilla. Kur prova e paraqitur nga njëra palë është në formën e dëshmisë ose dëshmisë nën betim, atëherë secila palë tjetër ka mundësinë për të marrë në pyetje personin që ka dhënë dëshminë nën betim apo që ofron një dëshmi të tillë, ose nëpërmjet dëshmisë në gjykatë, ose nëpërmjet dhënies së dëshmisë nën betim që është e xhiruar në video/audio shirit dhe që është e transkriptuar.  
[...]

## **LIGJI Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

### **Neni 40**

#### **Prioritetet e kërkesave dhe interesave**

1. Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim:

1.1.kostot e shitjes apo realizimit në mënyra tjera të pronës apo aseteve të ndërmarrjes;

1.2.kredia e siguruar pas Kërkesës për Riorganizim e shkaktuar në pajtim me nenin 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 ose Ligjit për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara, cilido që është në fuqi në atë kohë, në atë masë që kredia të jetë aprovuar nga Gjykata. Ky prioritet ka të bëjë vetëm me të hyrat nga shitja apo transferimi në mënyra tjera i aseteve që sigurojnë kredinë;

1.3.kërkesat prioritare në renditjen në vijim:

1.3.1.shpenzimet e Gjykatës;

1.3.2.shpenzimet e Autoritetit të Likuidimit dhe këshilltarëve mbështetës;

1.3.3.shpenzimet e Autoritetit të Likuidimit të nevojshme për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe aseteve të ndërmarrjes;

1.3.4.shpenzimet për operimin e vazhdueshëm të ndërmarrjes pas vendimit të Agjencisë apo Gjykatës për të filluar procedurat e likuidimit; dhe

1.3.5.të gjitha Kërkesat për Shpenzimet Administrative të shkaktuara gjatë riorganizimit apo gjatë procedurave të likuidimit;

1.4.kërkesat e siguruara deri në masën e realizuar nga asetet që sigurojnë kërkesat e tilla në shumën e atyre Kërkesave të siguruara dhe Kërkesave tjera;

1.5.kërkesat bazuar në pronësinë e aseteve specifike përfshirë pasuritë e patundshme;

*1.6.kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim:*

*1.6.1.kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person;*

*1.6.2.kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në ;*

*1.7.kërkesat e pasiguruar, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë;*

*1.8.kërkesat e pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve apo partnerëve në ndërmarrje.*

*2. Kërkesat brenda të njëjtës kategori apo të njëjtës renditje radhiten në mënyrë të barabartë pavarësisht kohës kur janë paraqitur.*

*3. Kërkesat do të përmbushen sipas prioritetit sipas kategorisë dhe renditjes të përcaktuar në këtë nen. Pagesat për përmbushje të Kërkesave do të bëhen në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 41 të këtij ligji dhe i ndjekin procedurat e Autoritetit të Likuidimit në pajtim me politikat financiare të agjencisë të nxjerra në pajtueshmëri me nenin 15 të Ligjit për AKP-në.*

## **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

27. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

29. Gjykata poashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata së pari u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afati]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”*

30. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

31. Megjithatë, Gjykata i referohet paragrafit (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

32. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin K104/21, parashtrues *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26 shih gjithashtu rastin K1175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

33. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e



një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, (shih rastin K104/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin K175/20, cituar më lart, paragrafi 38).

34. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin K104/21, cituar më lart, paragrafi 28).
35. Rrethanat e rastit konkret, rezultojnë nga kërkesa e parashtruesit të kërkesës pranë Autoritetit të Likuidimit për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën dhjetor 2006 deri dhjetor 2007 në vlerë prej 3,484.07 Euro. Autoriteti i Likuidimit kishte kompensuar parashtruesin në shumën prej 1,740 Euro, duke theksuar se në llogaritjen e shumës, ka marrë parasysh pagën mujore në momentin e pushimit nga puna dhe vitet faktike të shërbimit në punë. I pakënaqur me këtë vendim, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë pranë DHPGJS-së, e cila në shkallën e parë vendosi të refuzojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës, nuk ka ofruar dëshmi relevante që dëshmon se N.SH i ka mbetur atij borxh pagat e kërkuara, përkatësisht faktin që ai ka ofruar shërbime për N.SH-në, për periudhën dhjetor 2006- dhjetor 2007. Me këtë rast, parashtruesi i kërkesës, parashtroi ankesë pranë Kolegjit të Apelit, duke iu referuar mes tjerash Aktgjykimit AC-I-14-0119-A0001 duke theksuar se Kolegji i Apelit, ka obliguar AKP-në që personit N.Z, t’ia paguajë shumën përkatëse në emër të pagave të papaguara, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj. Kolegji i Apelit, vendosi që parashtruesi i kërkesës (i) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante për të dëshmuar se N.SH "Xim Strezovci" i ka mbetur atij borxh për pagat e kërkuara; (ii) nuk ka ofruar asnjë dëshmi që vërteton se ai ka ofruar shërbime për NSH-në në periudhën për të cilën kërkon kompensim; dhe (iii) nuk ka ofruar dëshmi për lartësinë e pagës dhe llogaritjen e shumës së kërkuar.
36. Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit të kërkesës pranë Gjykatës ndërlidhen me qëndrimet e Kolegjit të Apelit, në raport me Aktgjykimet tjera përkatëse të cilat parashtruesi i konsideron “identike/ të ngjashme” me rastin e tij. Në këtë linjë duke pretenduar shkelje të nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës i referohet rasteve “identike/njëjta” përkatësisht Aktgjykimit AC-I-15-0178 të 23 prillit 2020 dhe Aktgjykimit AC-I-14-0119 të 19 dhjetorit 2019, aktgjykime këto të cilat sipas parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me të njëjtën çështje, bazë faktike e ligjore, palë të paditur, njëjtë si me rastin e parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës K145/18, pretendon se pretendimi i tij lidhur me precedentin gjyqësor, nuk është trajtuar nga Kolegji i Apelit.
37. Gjykata fillimisht do trajtojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me vendimin e arsyetuar gjyqësor, duke vazhduar më pas me pretendimin lidhur me

precedentin gjyqësor, në rastet “identike/ngjashme” me rastin parashtruesit të kërkesës.

(a) *Sa i përket pretendimit për vendim të pa arsyetuar gjyqësor*

38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij pranë Kolegjit të Apelit, kishte theksuar se ka paraqitur prova të mjaftueshme përmes të cilave ka vërtetuar pretendimet e tij, dhe iu ishte referuar Aktgjykimit AC-I-14-0119-A0001 me paditës N.Z. Në këtë linjë parashtruesi i kërkesës, pranë Gjykatës duke iu referuar rastit të N.Z., thekson se të njëjtit Kolegji i Apelit, kishte vendosur që AKP t’ia paguajë shumën përkatëse në emër të pagave të papaguara, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se është krijuar precedent me këtë rast, dhe Kolegji i Apelit nuk iu ishte përgjigjur pretendimeve të tij, ku në këtë pikë, parashtruesi i kërkesës iu referuar edhe Aktgjykimit të Gjykatës KI145/18 (*parashtrues Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahim*, Aktgjykim i 19 korrikut 2019),
39. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
40. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
41. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit

dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI195/20, parashtrues *Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego"*, Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 122).

42. Gjykata me këtë rast rikujton se Autoriteti i Likuidimit fillimisht, kishte kompensuar parashtruesin në shumën prej 1,740 Euro, duke theksuar se në llogaritjen e shumës, ka marrë parasysh pagën mujore në momentin e pushimit nga puna dhe vitet faktike të shërbimit në punë.
43. Gjykata e shkallës së parë të DHPGJS-së, kur refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës kishte theksuar si në vijim:

*"Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon pala pretendon një fakt apo ngjarje, ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtruesat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuar), ndërsa pika 3 parasheh që pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar prova materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon ta paraqesë apo të dorëzojë prova të tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.*

*Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë që ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat kontestohen fakte të tilla. [...]*

*Me këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur atij borxh pagat e kërkuara, poashtu ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ka ofruar shërbime për NSH, për periudhën dhjetor 2006- dhjetor 2007, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara, por vetëm në mënyrë të përgjithësuar ka parashtruar kërkesë në shumë prej 3,484.07 Euro. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara."*

44. Më tej, Kolegji i Apelit në Aktgjykimin AC-I-20-0550-A0001, i 7 tetorit 2021 kishte theksuar:

*"[...]Kolegji i Apelit konsideron se ankuesi nuk ka dëshmuar me asnjë provë apo fakt konkret që mbështet pretendimet e tij.*

*Kolegji i Apelit pajtohet në tërësi me gjetjet e shkallës së parë se, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante për të dëshmuar se NSH i ka mbetur borxh atij për pagat e kërkuara, se nuk ka ofruar asnjë dëshmi që vërteton se ai ka ofruar shërbime për NSH-në për periudhën për të cilën kërkon kompensim, nuk ka ofruar asnjë dëshmi për lartësinë e pagës dhe llogaritjen e shumës së kërkuar.*

*As para Kolegjit të Apelit ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij. Ankuesi ka qenë i ndërgjegjshëm për arsyet e refuzimit të kërkesës së tij edhe para AL të AKP-së edhe para shkallës së parë të DHPGJSK-së, por pos aspektit deklarativ, asnjë provë apo dëshmi nuk e ka ofruar në mbështetje të këtyre deklarimeve.*

*Kolegji i Apelit ka gjetur se paditësi ka prezantuar një dëshmi të vetme, Njoftimin e AKP-së për mundësinë e parashtrimit të kërkesave eventuale ndaj NSH-së, por kjo provë nuk është e mjaftueshme për njohjen e të drejtës së pretenduar.*

*Kolegji i Apelit nuk mund ta pranojë argumentin e paditësit se vetëm për faktin se ai ka bërë kërkesë në proces të likuidimit, kërkesa e tij duhej të miratohej. Siç e ka konstatuar me të drejtë edhe Shkalla e parë e DHPGJSK-së, konform nenit 42 pika 2 e Ligjit për DHPGJSK-së, pala që pretendon një fakt apo ngjarje, e ka barrën e dëshmisë për vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke parashtruar prova materiale (dokumente fizike dhe dëshmuere). Në këtë rast pala paditëse ka dështuar që t'i mbështesë pretendimet e tij, andaj me të drejtë kërkesa është refuzuar.*

*[...]"*

45. Gjykata vëren se fillimisht Gjykata e shkallës së parë të DHPGJS-së e më pas edhe Kolegji i Apelit, duke u mbështetur në paragrafin 2 të nenit 42 të Ligjit për DHPGJS-në, në esencë theksuan se pala që pretendon ndonjë fakt apo ngjarje, e ka barrën e dëshmisë dhe vërtetësisë së pretendimit të tillë, duke parashtruar prova materiale (dokumente fizike dhe dëshmuere), e të cilat parashtruesi i kërkesës ka dështuar të i dorëzojë. Në këtë aspekt, Kolegji i Apelit, konstatoi se parashtruesi i kërkesës (i) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante për të dëshmuar se N.SH "Xim Strezovci" i ka mbetur atij borxh për pagat e kërkuara; (ii) nuk ka ofruar asnjë dëshmi që vërteton se ai ka ofruar shërbime për NSH-në në periudhën për të cilën kërkon kompensim; dhe (iii) nuk ka ofruar dëshmi për lartësinë e pagës dhe llogaritjen e shumës së kërkuar. Duke iu referuar dëshmive, Kolegji i Apelit, theksoi se parashtruesi i kërkesës kishte ofruar një dëshmi të vetme, përkatësisht Njoftimin e AKP-së për mundësinë e parashtrimit të kërkesave eventuale ndaj NSH-së.
46. Gjykata me këtë rast, rikujton se nisur nga praktika e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, e njëjta nuk kërkon përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar.
47. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës fillimisht në ankesën e tij kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit konsideron se do duhej të zbatohet



neni 40 i Ligjit për AKP-në, pretendim ky që ishte theksuar edhe në ankesën e tij pranë Kolegjit të Apelit. Në ankesën e tij pranë Kolegjit të Apelit, parashtruesi i kërkesës, mes tjerash iu ishte referuar edhe rastit të N.Z, duke theksuar se Kolegji i Apelit, ka obliguar AKP-në që personit N.Z, t'ia paguajë shumën përkatëse në emër të pagave të papaguara, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj. Të njëjtin pretendim të parashtruesit, Kolegji i Apelit e kishte cituar në Aktgjykimin e tyre, por Kolegji i Apelit, në arsyetim ishte përgjigjur lidhur me paraqitjen e provave përkatëse nga parashtruesi i kërkesës, i cili nuk ka ofruar dëshmi relevante për të vërtetuar pretendimet e tij.

48. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, konsideron se përgjigja lidhur me rastin e personit N.Z, nuk ishte vendimtare dhe përcaktuese lidhur me rrethanat e parashtruesit të kërkesës, sepse fillimisht, Kolegji i Apelit, bazuar në nenin 42 të Ligjit për DHPGJS-në, do duhej të mbështetej në provat relevante, për të vendosur lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës (shih lidhur me çështjen e pretendimeve vendimtare dhe përcaktuese, KI195/20, parashtrues *Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego"*, cituar më lart, paragrafët 126, 128 dhe 135). Për ndryshim, në rastin e cituar nga parashtruesi i kërkesës KI145/18, Gjykata kishte konsideruar se pretendimi i parashtruesve në atë rast për trajtim të pabarabartë para gjykatave, ishte thelbësor dhe i mbështetur në dëshmi materiale (shih Aktgjykimin KI145/18, cituar më lart, paragrafin 57).
49. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në *"mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"* ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

*(b) Sa i përket pretendimit lidhur me rastet identike/ngjashme*

50. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se personat SH.H dhe N.Z, kanë prezantuar pranë gjykatave të rregullta prova përkatëse, të njëjta me parashtruesin e kërkesës, por në rastin e tij, gjykatat kanë vendosur ndryshe nga praktika. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se vendosja ndryshe në dy çështje identike me mos-marrja parasysh e aktgjykimeve që ai i quan precedent, paraqet devijim i praktikës, interpretim i gabuar i ligjit, dhe gjykim subjektiv i gjykatës, në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.
51. Për të argumentuar situatën e njëjte faktike dhe juridike parashtruesi i kërkesës thekson se për personat SH.H dhe N.Z, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimeve AC-I-15-0178 dhe AC-I-14-0119, ka obliguar AKP-në që t'iu kompensojë pagat e papaguara personave në fjalë me arsyetimin se *"personat në fjalë kanë qenë të punësuar në N.SH. Xim Strezovci deri në ditën e privatizimit të saj, kur edhe iu janë ndërpre Kontratat e Punës"*. Pra në esencë, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk ka pasur konsistencë në vendimet e Kolegjit të Apelit.



52. Me këtë rast, Gjykata rikujton se GJEDNJ ka theksuar se, përveç rasteve të arbitrarisht të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore. (Shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118; dhe *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 50) dhe në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër, GJEDNJ-ja ka theksuar se nuk mund të konsiderohet të ketë divergjencë në praktikën gjyqësore kur gjendjet faktike të çështjes janë objektivisht të ndryshme. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Uçar kundër Turqisë*, Vendim i 29 shtatorit 2009). Njëlloj, trajtimi i dy kontesteve në mënyrë të ndryshme nuk mund të konsiderohet se krijon praktikë gjyqësore divergjente kur kjo arsyetohet nga një ndryshim në gjendjet faktike në fjalë. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Hayati Çelebi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, paragrafi 52; si dhe *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 116 si dhe shih rastin e Gjykatës KI35/18, parashtrues: *Bayerische Versicherungsverband*, cituar më lart, paragrafi 68).
53. Megjithatë, Gjykata rikujton se GJEDNJ ka trajtuar jokonsistencën e vendimeve gjyqësore në kuadër të nenit 6 të KEDNJ-së. GJEDNJ ka vendosur tri kritere themelore, të cilat janë pranuar edhe në praktiken gjyqësore të Gjykatës për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përben shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të cilat përcaktojnë si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime "të thella dhe afatgjata" në praktiken gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe në çfarë mase (Në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr. 1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116 - 135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih rastin e Gjykatës, KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës, KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 39; KI87/17 parashtrues "*IF Skadiforsikring*", cituar më lart, paragrafi 67, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, KI35/18 parashtrues "*Bayerische Versicherungsverband*", Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 70, KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, dhe KI45/19, parashtrues *Komuna e Vushtrrisë*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 tetorit 2020, paragrafi 34).
54. Gjykata poashtu në praktikën e saj ka theksuar se parashtruesit e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktike gjyqësore, duhet t'ia paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërtënëse në praktiken gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin e cituar më lart KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 76;

dhe rastin KI 45/19, parashtgues *Komuna e Vushtrrisë*, cituar më lart, paragrafi 40).

55. Gjykata vëren se parashtguesi i kërkesës, përpos pretendimit se (i) “*personat në fjalë kanë qenë të punësuar në N.SH. Xim Strezovci deri në ditën e privatizimit të saj, kur edhe iu janë ndërpre Kontratat e Punës*” dhe se (ii) parashtguesi i kërkesës ka paraqitur prova të njëjta me personat në fjalë, ai nuk ka sqaruar se si kanë ngjashmëri faktike dhe juridike rastet përkatëse me rastin e parashtguesit të kërkesës dhe si kanë rezultuar ato në vendime kundërthënëse.
56. Për më tepër, Gjykata thekson se në dritën e praktikës së GJEDNJ-së, kriteri kryesor për të vlerësuar nëse vendimet kundërthënëse janë “dukshëm arbitrare”, është “ekzistimi i dallimeve të thella dhe të vazhdueshme”, në praktikën gjyqësore përkatëse. Lidhur me këtë Gjykata konstaton se në bazë të dy Aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit, të nxjerra njëra në 2019 e tjetra në 2020, e të cilat pretendohet se janë të ngjashme, por nuk vërtetohet ngjashmëria e tyre, nuk është e mundur të kuptohet se ka “dallimeve të thella dhe të vazhdueshme” në praktikën gjyqësore të Kolegjit të Apelit, e që do të mund të rrezikonte parimin e sigurisë juridike, dhe me këtë, të rezultonte në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës, Kl29/17, *Adem Zhegrova*, cituar me lart, paragrafi 53, dhe *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 44; si dhe rasti KI53/21, parashtgues *Limak Kosovo International Airport SH.A. "Adem Jashari*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 majit 2021).
57. Në raport me pretendimet e mësipërme, Gjykata poashtu thekson se parashtguesi i kërkesës përderisa pranë Kolegjit të Apelit, ka pretenduar se rasti i tij është i ngjashëm me rastin e paditësit N.Z (Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit, AC-I-14-0119 i 19 dhjetorit 2019), parashtguesi pranë Gjykatës ka bashkangjitur vetëm lëndën e paditësit SH.H, (Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit, AC-I-15-0178). Nga rasti i këtij të fundit, përkatësisht nga Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së lidhur me paditësin SH.H, Gjykata vëren se shkalla e parë kishte arsyetuar mes tjerash, lidhur me faktin që ankuesi figuron në listën e pagave të papaguara të N.SH-së, dhe nëse ai nuk do figuronte në listën në fjalë “*pra nëse nuk mund të dëshmonte që NSH-ja i ka mbetur borgj, situata do ishte ndryshe.[...]*”.
58. Konstatimi i mësipërm lidhur me rastin e SH.H, dallon nga rasti i parashtguesit të kërkesës, sepse i njëjti, siç është sqaruar edhe më lart, pranë gjykatave të rregullta, nuk kishte bashkangjitur prova përkatëse. Për më tepër, lidhur me paraqitjen e provave, Gjykata rikujton se Kolegji i Apelit në Aktgjykimin AC-I-20-0550-A0001 të 7 tetorit 2021, kishte theksuar se parashtguesi i kërkesës kishte bashkangjitur vetëm “*Njoftimin e AKP-së për mundësinë e parashtrimit të kërkesave eventuale ndaj NSH-së*”.
59. Marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata në fund, thekson se pakënaqësia e parashtguesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

60. Përfundimisht, bazuar në rrethanat e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për divergjencë në praktikë dhe rrjedhimisht, edhe këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese në *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 e 47 të Ligjit, rregullat 39 (2) e 59 (2) të Rregullores së punës, më 16 shkurt 2022, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Selvetë Gërxhalie-Krasniqi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani